Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0994

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Vjosa Gradinaj Mexhuani dhe Isa Hasani - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së (OE) "Prishtina Auto" L.L.C kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të Policia e Kosovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Autobusa për Policinë e Kosovës-Ritender1", me nr. të prokurimit: "214-23- 10050-1-1-1", me 17/04/2024, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE "Prishtina Auto" L.L.C me nr. 2023/994 , e datës 11/12/2023, kurse vendimi i AK Kuvendi i Komunës së Prishtinës lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Autobusa për Policinë e Kosovës-Ritender1", me nr. të prokurimit: "214-23- 10050-1-1-1", mbetet në fuqi.

2. Lejohet të bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- *Faktet dhe rrethanat procedurale* --

Me 20.09.2023, Policia e Kosovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Furnizim me Autobusa për Policinë e Kosovës-Ritender1", me nr. të prokurimit: "214-23- 10050-1-1-1".Ndërsa me datën 22.11.2023 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë OE "Ideal Shala" B.I.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës **1,200,000.00 €.**

Me 27.11.2023, OE "Prishtina Auto" L.L.C ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 01.12.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 11.12.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "Prishtina Auto" L.L.C me nr. 994/23 për lidhur me aktivitetin "Furnizim me Autobusa për Policinë e Kosovës-Ritender1", me nr. të prokurimit: "214-23- 10050-1-1-1".

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Prishtina Auto" L.L.C *janë parashtruar si në vijim:*

*Pretendimi i parë (I):Ankuesi pretendon: "*Duke u bazuar në vendimin e datës 01.12.2023 të AK-së mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim parashtruar nga OE Prishtina Auto L.L.C., lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Autobusa për Policinë e Kosovës" Ritender1 me numër të prokurimit: 214-23-10050-1-1-1; 214/23/135/111, ne i hedhim si të tërësisht të pa bazuara dhe plotësisht antiligjore pretendimet e AK-së sepse: I. AK e ka shkel Nenin 1 të LPP-së sepse është e qartë se AK nuk e ka udhëheq këtë aktivitet tenderik në pajtim me parimet bazike siç ceken në pikën 4.3 të Nenit 4 të Rregullores Nr. 001/2022 për prokurimin publik. AK ka deviju në shqyrtimin korrekt, profesionalisht dhe për lëndën në fjalë duke e shkelur fillimisht Aneksin 6 të DT-së si rezultat e së cilës e rekomandon për dhënie të kontratës një OE i cili ka ofertuar çmim më të lartë sesa oferta jonë, derisa përveç çmimit më të lartë sesa oferta jonë OE e rekomanduar

për kontratë është e papërgjegjshme bazuar në pretendimet tona të cekura në kërkesën për rishqyrtim të datës 27.11.2023 si dhe të tjera pretendime të dala pas dt. 27.11.2023! Ne i mbesim mrapa pretendimeve tona se oferta jonë i përmbush të gjitha kriteret dhe specifikimet teknike të shpallura në DT me numër të prokurimit të lartë cekur dhe si rezultat i kësaj oferta jonë është plotësisht e përgjegjshme, derisa pretendimet e AK-së se ne kemi ndryshuar të dhëna në DT asesi nuk qëndrojnë pasi që në përgjigjen për sqarim të dosjes flitet vetëm për një gabim shkrimor i bërë nga prodhuesi i Autobusëve i cili zyrtarisht e ka prezentu deklaratën me shkrim drejtuar AK-së, dhe ka sqaruar gabimin e lëshuar në fjalë, e si rezultat i kësaj, AK nuk e ka marrë përbazë fare deklaratën e prodhuesit tonë për gabimin teknik të lëshuar. Pavarësisht këtij fakti, ne vazhdimisht kemi deklaruar se edhe pse është gabim teknik i lëshuar nga prodhuesi ynë, specifikimi teknik, respektivisht Specifika që lidhet me këtë detaj prap se prap përmbushet nga ana jonë, sepse AK e ka kushtëzuar linjën numër 6 me "min" (m) 9,150, derisa ne prap se prap i tejkalojmë vlerat e specifikimeve teknike të përcaktuara nga AK si minimum standard i kërkuar nga i njëjti. Kushti i linjës numër 6 është se gjatësia duhet me qenë "minimum"(m) 9,150 në ligjin e prokurimit nënkupton që Makineria në fjalë, respektivisht Autobusi i kërkuar nuk guxon të jetë me vlerë më të vogel se kjo e cekur. Oferta jonë, respektivisht Autobusi i ofertuar nga ne e tejkalon këtë shifër sepse gjatësia e autobusit tonë të ofruar është 12340 mm. Ka qenë gabim teknik shkrimor gjatësia 13340 mm (në vend të numrit 2 është shkruar numri 3), e që ne e kemi njoftuar AK-në për këtë gabim shkrimi!. Njëjtë ka vepru edhe prodhuesi i cili me deklaratë të lëshuar nga vet ai i drejtohet AK-së për gabim shkrimin të lëshuar e që AK, natyrisht me tendencë nuk e merr përbazë fare. Kjo ka të bëjë vetëm me gabim shkrimi, e që LPP-ja dhe rregulloret e prokurimit publik përmbrenda procedurave ligjore i marrin parasysh ato, dhe si të tilla, duke qenë se nuk e ndryshojnë strukturën e Specifikave Teknike të kërkuara në DT, dhe janë dhe mbesin brenda kritereve të kërkuara nga AK, gabim shkrimin shpjegohet e sqarohet nga OE (egzakt siç kemi vepruar ne në rastin në fjalë), derisa në rastin në fjalë AK-ja nuk ka të drejtë të na shpallë të papërgjegjshëm, sepse ne prap se prap e plotësojmë kriterin e cekur në numër 6 të specifikimit teknik. Në një linjë tjetër AK bie ndesh me pretendimet e saj duke deklaruar edhe vet se oferta jonë është e përgjegjshme mirëpo AK pretendon se oferta jonë është me çmim më të lartë se ajo e OE të rekomanduar për kontratë!. Ky pretendim i AK-së nuk qëndron sepse oferta jonë e përgjegjshme është me çmim më të ulët nga ajo e OE të rekomanduar me kontratë, këtë e dëshmon raporti i hapjes së tenderëve. Po e citojmë atë se çfarë AK ka deklaruar: Oferta juaj është oferte e përgjegjshme me çmimin me te larte se OE i rekomanduar për kontratë*"*

*Pretendimi i dytë (II): "*Neni 6 i LPP-së kjartësisht thotë se Autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdorën në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit. AK Policia e Kosovës në këtë rast ka bërë shkelje të Nenit 6 të LPP-së sepse me veprime të tilla po rezulton që fondet publike dhe burimet publike po keqpërdoren duke tentuar ti japë kontratën një OE me çmim më të lartë nga oferta jonë, kjo nuk ka të bëjë fare me profesionalizëm e mos të flasim për transparencë sepse këtu kemi të bëjmë me keqpërdorim të fondeve publike dhe burimeve publike, fondet në fjalë nuk po përdoren në mënyrën më ekonomike siç Neni 6 në fjalë

e vulos. Po ashtu, AK me ketë veprim jo që e ka respektuar kriterin e dhënies së kontratës respektivisht Nenin 6 të DT-së siç pretendon por e ka shkel atë kriter për dhënie të kontratës në mënyrë flagrante sepse kriteri për dhënie të kontratës është çmimi më i ulët dhe ne, OE Prishtina Auto L.L.C., jemi ofertues me çmim më të ulët me një diferencë të çmimimit prej 32,440.00 Euro më të ulët nga OE i rekomanduar për kontratë."

Pretendimi i tretë (III) : "Nuk qëndron pretendimi i AK-së i cili pretendon se nuk e ka shkel Nenin 7, sepse i njëjti e ka shkel atë duke na diskriminuar neve si OE pjesëmarrës në këtë aktivitet tenderik. AK nuk na ka trajtu të barabartë me OE të rekomanduar për kontratë, sepse AK nuk e ka marrë përbazë fare deklaratën e prodhuesit tonë dhe kulminante është veprimi i AK-së i cili në letrën standarde B47 të datë 03.11.2023 - Letër standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit kërkon nga OE i rekomanduar për kontratë sqarime si në vijim: Ne dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontrate eshte kërkuar kriteri: Kerkesa 1 - Katlog nga prodhuesi me përshkrim te detajuar te karekteristikave teknike, me te cilën është e mundur vlerësimi i specifikacioneve teknike te ofruar. Ju keni dorëzuar katalog te prodhuesit por nuk keni pasur mundësi me evidentua te gjitha specifikat qe janë kërkuar sipas Aneksit 1. Ju lutem na dërgoni katalogun te hijezuar-nënvizuar sipas specifikave te kërkuar ne Ankesin 1. OE i rekomanduar për kontratë deklarohet si në vijim: Katalogun te cilin ju kemi bashkangjitur është katalog nga prodhuesi Isuzu i cili katalog është unik ndërkombëtar ku nuk i ka te detajuar te gjitha specifikimet teknike qe autobuset permbajne per ketë ne kemi kërkuar nga Prodhuesi i autobuseve te na ipen sqarime shtese lidhur me kërkesën nga AK-Policia e Kosovës dhe ne kemi pranuar Konfirmim nga Prodhuesi Isuzu i cili ka dëshmuar me deklarate te nënshkruar dhe vulosur specifikat e detajuara te cilat nuk janë specifikuara ne Katalog. Katalogu është i bashkangjitur dhe janë te nënvizuara specifikat sipas Ankesit 1 po ashtu deklaratën e prodhuesit e kemi bashkangjitur për disa nuk janë te detajuara ne katalog te Prodhuesit .Dhe këtu fillon haptazi shkelja e Nenit 7 të LPP-së nga ana e AK-së sepse i njëjti e ka marrë parasysh këtë deklaratë të OE të rekomanduar për kontratë dhe nuk e ka marrë fare parasysh deklaratën e prodhuesit tonë, e që ska mëdyshje që AK me dy këmbët e ka shkelë Nenin 7 sepse AK nuk ka bërë trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik, haptazi ka treguar diskriminim ndaj kompanisë tonë, haptazi duke aplikuar e manifestuar standarde të dyfishta, e që totalisht një gjë e tillë bie fort ndesh me LPP-në! Sa i përket sqarimit të AK-së për deklarata tatimore vjetore ne kemi bërë ngarkimin e dokumentit të njëjtë në sistemin e-prokurimi dhe besojmë se duhet të mbetet në përgjegjësi të OSHP-së që të verifikohet dallimi nëse ka ndonjë dallim në mes dokumentit që është ngarkuar herën e parë gjatë aplikimit në këtë aktivitet tenderik me atë gjatë kërkesave të sqarimeve shtesë të kërkuar nga AK-ja.."

Pretendimi i katërt (IV) : "Neni 10 është shkelur nga AK-ja sepse dokumenti në fjalë që na është mohuar ta kemi si kopje nuk është në atë nivel që të kategorizohet me rastet e cekura si në Nenin 11 të LPP-së, pika 3, nënpika 3.1. Për më tepër, dokumenti nuk e gëzon statusin e pikës 3, nënpikës 3.2 të Nenit 11 të LPP-së sepse nuk është kategorizuar fare si dok. sekret. AK deklaron se personit i cili ka qenë në qasje i është ofruar ti shikojë që kanë ekzistuar këto dokumente, një

gjë e tillë nuk qëndron, sepse ne e dijmë se dokumenti gjithsesi duhet të egzistojë, mirëpo duke e ditur se personi që ka qenë në qasje nuk është i kualifikuar për të vlerësuar përshtatshmërinë dhe për të kualifikuar si dokumente që i përmbushin kriteret apo jo, personi në fjale ka kërkuar që gjithashtu edhe ai dokument ti ipet në një kopje të dokumentit në fjalë, mirëpo na është mohuar kjo e drejtë. Për fund, sipas Nenit 10 pika 8, le të jetë në përgjegjësi të OSHP-së që dokumenti në fjalë dhe përmbueshmëria e të njëjtës të verifikohet nga vet OSHP-ja."

Pretendimi i pestë (V):" Autoriteti kontraktues e ka shkelur Nenin 28 të LPP-së sepse i njëjti na ka eliminuar vetëm pse kemi pas një gabim shkrimi nga prodhuesi, i cili edhe direkt i është drejtuar AK-së me deklaratë zyrtare rreth gabimit të lëshuar në fjalë. Ne nuk e pranojmë se është ndryshim i përmbajtjes se Specifikacionit, por përmirësim i gabimit të shkrimit, brenda hapësirave të specifikimit teknik respektivisht linjës numër 6, sepse me mos lajmërimin e gabimit shkrimor do të mund të përballeshim pastaj me AK-në gjatë implementimit të kontratës në fjalë, respektivisht besojmë se nga persona të caktuar zyrtar do të sfidoheshim me pyetjen: Përse keni shkruar se Autobusi juaj është 13340mm ndërsa keni sjellë Autobus 12340mm?! Marrë parasysh këtë fakt, si dhe duke qenë se jemi luftëtarë të pa kompromis të t'qënit të ndershëm, profesional dhe shumë të përgjegjshëm, ne vet e kemi njoftuar AK-në për gabimin teknik të lëshuar nga prodhuesi ynë. AK nuk do shkelte në asnjë formë ligjet e aplikueshme të prokurimit publik nëse do e merrte parasysh deklaratën e prodhuesit tonë, dhe në përputhje me Nenin 59 të kërkonte përsëri kërkesa për sqarime shtesë duke sqaruar kështu në përpikmëri të gjitha pakjartësitë sepse këtu nuk kemi të bëjmë me ndryshim materiali por me gabim shkrimi. Nuk mundet me u cilësu ndryshim materiali një vlerë e cila është përbrenda një vlere të cekur dhe të kërkuar në specifikimin teknik në DT, e shpallur publikisht nga AK-ja. Këtu thjesht kemi të bëjmë me një gabim teknik e cila prap se prap është përbrenda kërkesave të specifikimit teknik dhe nuk përbën asnjë ndryshim materiali sepse produkti i ofruar mbetet 100% i njëjte, nuk ka devijime dhe se flitet vetëm për piken 6 që siç u citua disa herë më lartë përmbushet në tërësi si kriter! Le të vendos OShP-ja këtu se a kemi ndryshim materiali apo jo? Këtu flitet për produktin e njëjte 100% në përputhje të plotë me specifikimet teknike."

Pretendimi i gjashtë (VI) : " Siç u deklaruam më lartë në pikën V, AK po ashtu ka shkelur edhe Nenin 59, pika 2,3 dhe 4 sepse këtu kemi të bëjmë vetëm me gabim teknik. Për më tepër, AK ka bërë kërkesa për sqarime shtesë për diçka krejt tjetër. Ne vet e kemi lajmëruar gabimin teknik pasi që prodhuesi e ka vrejtë dhe i është drejtuar vet AK-së me deklaratë zyrtare rreth gabimit teknik të lëshuar në fjalë. Nuk është i vërtetë pretendimi i AK:

AK ka kërkuar sqarim shtese rreth katalogut te prodhuesit me datën 03.11.2023 Andaj bazuar ne nenin 72 te LPP dhe nenin 39.8 te RRUOPP kërkoj nga ana juaj qe te na dorëzoni katalogun nga prodhuesi sipas kërkesës se AK te kërkuar ne dosjen e tenderit dhe ne njoftimin për kontrate. OE

pas sqarimeve prape ka sjell broshure dhe jo katalog siç është kërkuar ne DT. Ne broshuren e dorëzuar se bashku me ofertën ka ofruar dimensione. Ne kemi dorëzuar katallog nga prodhuesi me të gjitha të dhënat teknike të detajizuar, katallog i njejtë të cilin e bashkangjesim për shqyrtim nga OSHP-ja. Nëse AK do të ishte referuar Nenit 59 të LPP-së besojmë se do të ishte kjartësuar rasti në fjalë. Sa i përket deklaratës të AK-së në vijim: Ndërsa sa i përket OE te rekomanduar i cili pretendon se nuk plotëson te gjitha spefikimet teknike AK sqaron se nuk qëndron kjo pasi qe OE i rekomanduar ka dorëzuar katalog te prodhuesit dhe jo broshure sepse katalogu nuk mund te modifikohet ose te plotësohet pikat te cilat nuk kane qene ne katalog janë mbuluar me deklarata te prodhuesit te nënshkruar dhe vulosur. Sa i përket deklaratës të AK-së në vijim: Ne deklarojmë si në pikën III meqenëse AK Policia e Kosovës nuk e ka marrë parasysh fare deklaratën e prodhuesit tonë mirëpo deklaratën e prodhuesit të operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë e ka marrë parasysh, kjo shpie drejt shkeljës së Nenit 7 sepse AK nuk na ka trajtuar barabartë me OE të rekomanduar me kontratë por na ka diskriminuar duke e rekomanduar për kontratë një OE të papërgjeshëm. Përse AK është në gjendje të merr përbazë një deklaratë të një prodhuesi siç është ajo e OE të rekomanduar për kontratë e jo të mirret përbazë edhe deklarata e prodhuesit tonë, kjo për neve është diskriminim me pasoja shumë të mëdha edhe për neve si OE edhe padyshim për Institucionin në veçanti dhe Shtetin e Kosovës në përgjithësi! Sa i përket deklaratës të AK-së në vijim: Ndërsa sa i përket Autorizimit pas shitjes kriteri ne dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontrate ka qene c) Autoriaimi nga prodhuesi ose Distributori i autorizuar i Prodhuesit për shitje (me titull dhe nr. Prokurimit te projektit ne fjale, ne kohëzgjatje te kontratës prej 36 muaj), Autorizimi i prodhuesit lëshuar për OE te rekomanduar është plotësisht sipas kërkesës ne DT dhe ne njoftimin për kontrate (shih me poshte), Letter Of Authorization Hereby We, Anadolu Isuzu Otomotiv Sanayii Ve Ticaret A.S. (Herein after mentioned as "Anadolu Isuzu") confirm that: This authorization is valid for a period of 36 months enter into force with the date of the signature procurement contract. 04.10.2023. Është në kundërshtimshtim të plotë me kërkesat e DT-së, Seksioni II, Neni 7.1&7.2 pika C sepse autorizimi në fjalë nuk ka validitet sepse siç e kemi cek edhe në kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së, aty ne autorizim ceket dhe decidivisht thuhet: Allmakes Global Services N.P.SH. (Herein after mentioned as "Allmakes") becomes an athorization partner for sales if The Procurment is awarded. This Letter of Athorization is valid with the condition of the Procurment is awarded by Allmakes. AK duhet të sqarohet rreth pretendimeve tona dhe jo t'i japë kahje tjeter kërkesave tona për rishqyrtim sepse ne prapë e potencojmë se autorizimi i përfshirë në DT nuk ka validitet sepse aty kjartë ceket se OE autorizohet për shitje vetëm nëse i njëjti shpërblehet me kontratë, dhe se ky autorizim është valid vetëm me kusht që OE të shpallet fitues i tenderit. Kjo tregon kjartë se që nga afati i fundit i dërgimit të ofertave, Autorizimi nuk ka qenë i vlefshëm apo më mirë të themi autorizimi nuk qe i plotfuqishëm që nga fillimi i dërgimit të dosjës përmes sistemit e-prokurimi respektivisht para hapjës së ofertave dhe gjatë shqyrtimit të ofertave deri në një vendim të AK-së për rekomandim të OE për kontratë. Po ashtu AK pretendon se dokumenti në fjalë ka validitet nga data 04.10.2023, nëse është kështu atëherë kjo bie ndesh me Nenin 7.1&7.2 pika C të DT-së sepse aty ceket kjartë:

c)Autorizimi nga prodhuesi ose Distributori i autorizuar i Prodhuesit për shitje(me titull dhe nr. Prokurimit të projektit në fjalë, në kohëzgjatje të kontratës prej 36 muaj). Nëse është në kohëzgjatje të kontratës prej 36 muaj atëherë kjo qe në kundërshtim me këtë nen sepse autorizimi është lëshuar me datë 04.10.2023 e që i bie se ne jemi në muajin 12/Dhjetor 2023 e si rezultat i kësaj i bie që autorizimi nuk është në kohëzgjatje të kontratës prej 36 muajsh. Ky realitet bazohet edhe në deklaratën e AK-së në vijim: Po ashtu kemi edhe konfirmimet nga prodhuesi (shih me poshtë deklaratën), Just an Information, the Kosovo Ploce can more than 5 buses according to the tender budget during 36 months period of the contract throug NPSH Allmakes Global Services. Convenerate detalis with be negotated between Anadolu Isuzu and Npsh Sllmakes Global Servies separetely. Best Regardsl Sayglanmia, Anadolu Isuzu Autorizimi i lëshuar nga prodhuesi për OE të rekomanduar për kontratë ka shumë kundërshtime në vetvete, nuk qe i plotfuqishëm në afatet e lartëcekura dhe përbën shkelje të Nenit 7.1 & 7.2 pika C të DT-së sepse është e barabartë sikur që AK ka apliku pa këtë dokument meqenëse nuk ka pas validitet apo nuk qe i plotfuqishëm ditëve të shqyrtimit nga AK-ja meqenëse nuk ka qenë në fillim i rekomanduar për kontratë nga AK-ja. Me këto veprime AK haptazi ka shkel Nenin 59 të LPP-së dhe jo vetëm. Sa i përket deklaratës të AK-së në vijim: Pretendimet e juaj qe OE e rekomanduar nuk ka ofruar nga prodhuesi shërbime pas shitjes nuk qëndron pasi qe këto shërbim janë kërkuar nga OE dhe jo nga prodhuesi ku kemi dëshmi deklaratat nga OE i rekomanduar për se cilin kushte te kërkuar ne ankesin 1. Shih kërkesat ne ankesin te DT. Ne jemi deklaruar haptazi duke u bazuar në deklaratën e prodhuesit në vijim: Anadolu Isuzu hereby disclaims all lianility that may be directed to Anadolu Isuzu by the Procurement Authority or Allmakes, including after-sales service, spare parts supply, trining, penal clauses an compensation. Allmakes shall be solely respansible for any and all claims by the Procuremnt Authority. The responsobility of Anadolu Isuzo hereby disclaims is only for the sale of 5 Isuzu Visig buses to Allmakes for the Procurement. Anadolu Isuzu reserve the right to suspend, cancel or withdraw this authorization at any time unilateral notification without giving any reason. Bazuar në autorizimin e dhënë nga prodhuesi që ne e cilësojmë si autorizim-dokument pa validitet dhe i cili nuk qe i plotfuqishëm, aty ceket se OE i rekomanduar për kontratë autorizohet vetëm për shitjën e autobusëve dhe jo për shërbime të pas shitjës!. Si ka mundësi që AK-ja ta rekomandojë për kontratë një OE i cili nuk e gëzon të drejtën e pas shitjës respektivisht shërbime të pas shitjes, furnizim me pjesë rezervë, trajnimet siç janë kërkuar në DT e kështu me rradhë!."

*Pretendimi i shtatë (VII): "*AK ka bërë shkelje të Nenit 108/A pika 6 sepse ne kemi bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së me datë: 27.11.2023 01:32 dhe kemi pranuar vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim me datë 01.12.2023 15:54. I njëjti bazuar Nenit 108/A nuk na ka paralajmëruar për zgjatje të afatit për përgjigje të kërkesës tone për rishqyrtim. AK-ja nuk i ka përfillë afatet e përcaktuara me ligj të Prokurimit Publik për kthim të përgjigjes me shkrim kundrejt kërkesës tonë për Ri-shqyrtim të lëndës, dhe me ç'rast edhe ka bërë shkelje të ligjit në fjalë."

*Pretendimi i tetë (VIII): "*AK ka bërë shkelje të Nenit 65 respektivisht pika 1.3 sepse e gjithë kjo procedurë besojmë se bazohet në ndikim të pozitës zyrtare që shpie në konflikt të drejtpërdrejt interesi që lidhet drejtë për drejtë me Drejtorin e prokurimit Zr. Artan Fejza, pretendime këto të cilat do i shpalosim në seancat që do thirren nga Autoriteti me të drejtë të plotë për zgjidhje të kontesteve, respektivisht ankesave si kjo e jona e që i dedikohet AK-Policia e Kosovës , respektivisht kundër vendimit të Departamentit të Prokurimit, për më tepër vendimit për dhënje të Kontratës një Operatori Ekonomik i cili përveç se është më i shtrenjtë sesa oferta e Kompanisë tonë aty ka edhe konflikt të rëndë interesit, duke shfrytëzuar pozitën e drejtorit të prokurimit në Polici të Kosovës, ndikimin e tij përmbrenda institucionit ku i njëjti shpërblen me kontratë OE-në që ka lidhje të ngushtë dhe shumë të afërt me të! Ne duam vetëm drejtësi, dhe me atë që u prezentua këtu, ne kërkojmë nga OShP-ja që të anulojë njoftimin për dhënie të kontratës dhe të njëjten ta kthej në ri-vlerësim. Vërejtje: AK - Policia e Kosovës, departamenti i prokurimit sqarimet dhe përgjigjet kundrejt kërkesave të OE-ve, njëjtë sikur në përgjigjen e dt.01.12.2023 gjithmonë i kthen ato në tentativë kinse AK nuk i ka shkel nenet e cekura në proceset e evaluimit të tenderëve, dhe proceduarave përgjatë kërkesës për rishqyrtim, e që shumicën e rasteve, sikur në rastin tonë ato përgjigje nuk arsyetohet fare, vetëm decidivisht shkruhet: AK nuk e ka shkelë këtë ligj, as këtë ligj, as këtë, e diçka të tillë nuk e arsyeton fare! Andaj kërkojmë nga OSHP që ta ketë parasysh këtë fakt, përgjatë analizës që do i bëhet rastit nga persona profesional përbrenda OSHP-së!"

Duke u referuar pretendimeve si më sipër "Prishtina Auto" L.L.C konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin Neni 1, 6, 7, 10, 28, 59 pika 2, 3 dhe 4 dhe 108/A pika 6 dhe neni65 pika 1.3 të LPP-së dhe Rregullore Nr.001/2022 Për Prokurimin Publik Neni 4 pika 4.3 Dosja e Tenderit (Numri i prokurimit: 214-23-10050-1-1-1) Aneksi 6, Seksioni II, Neni 7.1&7.2 pika C. Ne kërkojmë nga OSHP që të anulojë njoftimin për dhënie të kontratës dhe të njëjtën ta kthej në ri-vlerësim.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim: "OE "Prishtina Auto II L.L.C." Prishtine lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim me Autobusa për Policinë e Kosovës" - Ritender 1 me numër te prokurimit 214-2310050-1-1-1; 214/23/135/111 duke pretenduar se janë bere shkelje te dispozitave te LPP, Ligjit nr. 04/ L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. Ligjin Nr. 05/ L-068 dhe Ligjin Nr. 05/ L-092, siç janë: Pretendimet ankimore të OE "Prishtina Auto " L.L.C." Ligji Nr. 04/1—042 Neni 1, Neni 6 pika 1, Neni 7 pika 1, pika 2, pika 3, pika 4.,Neni 10 pika 3, Neni 28 pika 9, Neni 59 pika 2, 3 pika 4 Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik: Neni 47.22. Autoriteti Kontraktues nuk e ka shkelur Neni 1 Qëllimi: Qëllimi i aktivitetit është marrja e furnizimeve plotësisht sipas kërkesave të AK dhe kriteret janë përcaktuar në përputhje me qëllimin e aktivitetit të prokurimit dhe si rrjedhojë AK ka siguruar mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, manin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

Komisioni i vlerësimit ka bërë vlerësimin e ofertave konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontrate dhe ka rekomanduar për kontratë OE që i ka plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontrate. Oferta e juaj është e ofertë e përgjegjshme me çmimin me të lartë se OE i rekomanduar për kontratë. Autoriteti Kontraktues nuk e ka shkelur Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti: AK nuk ka bërë shkelje të Nenit 6 të LPP-se pasi që Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit. Fondet publike dhe burimet publike që janë ofruar ose që janë vënë në dispozicion sipas një kontrate publike mund të përdoren vetëm nga kontrata e tillë dhe vetëm për qëllimet e të njëjtës. Policia e Kosovës ne këtë raste ka rekomanduar OE i cili ka plotësuar kriteret ne DT dhe Njoftim për kontrate dhe ka respektuar kriteri e dhënies. Autoriteti Kontraktues nuk e ka shkelur Nenin 7 i LPP-se- Barazia në Trajtim/ Jo Diskriminimi nuk qëndron : Autoriteti kontraktues ka trajtuar operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese dhe ka vepruar në mënyrë transparente. AK ka trajtuar te OE ne mënyrë te barabartë ka kërkuar sqarime te gjithë OE ne te njëjtën kohe dhe ka pranuar përgjigje ne te njëjtën kohe. Sa përket pike se AK ka bere shkelje te nenit 7 për arsye te kriterit Deklarata Tatimore Vjetore AK sqaron se nuk ka bere shkelje te këtij neni ju ka kërkuar sqarime për ketë pike se ne ofertën tuaj te dorëzuar ditën e hapjes deklarata tatimore vjet për Vitin por dokumente e dërguar për vitin 2021 dhe 2022 kane qene pa te dhëna (PA VLERA) siç jeni kon te njoftuar edhe ne letrën standarde për sqarim.

Për këtë arsye kemi kërkuar sqarim për jete kriter dhe pas ngarkimit ne sistem te sqarimeve nga ana juaj ky kriter është plotësuar dhe ka qene ne rregull dhe për këtë arsye nuk ju kemi shkru ndonjë vërejte ne standarde për elimin se është plotësuar ky kriter pas sqarimeve. Sa i përket Deklaratave tatimore ju e keni plotësuar këtë kriterin e kërkuar pas sqarimeve te kërkuara. Autoriteti Kontraktues nuk e ka shkelur Neni 10: Mjetet për promovimin e Transparencës Autoriteti kontraktues ka vepruar konform Ligji Nr. 04/L-042 Për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës. I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/1—237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 nenit 11 Neni 11 i informatat Sekrete Afariste, pika 3 OE te cilët i keni pruar dokumentacioni nuk kane paraqitur dokumente sekret por duke u bazuar ne Prokurim Publik të Republikës së Kosovës, 1 ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 nenit 11 Neni 11 Informatat Sekrete Afariste, pika 3 nuk janë ofruar këto dokument për ketë arsye dhe personi cili ka qene qasje ju është ofruar ti shikoj qe kane ekzistuar këto dokument por ka refuzuar me arsyetim se janë arkiva shtetërore. Autoriteti Kontraktues nuk e ka shkelur Neni 28 i LPP-se- Specifikimet teknike. Autoriteti kontraktues ka përpiluar specifikimet teknike në atë mënyrë që ato janë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Ju si OE nuk jeni eliminuar për arsyen se keni tejkaluar specifikacioni e kërkuar te pilca 6 por jeni eliminuar për arsye pas sqarimit te kërkuar JU keni bere ndryshim e këtij te pozicioni me numër 6 duke ofertuar . Sipas nenit 59 pika 2 te LPP-se, Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues. Andaj oferta juaj refuzohet pasi që kemi ndryshim materiali. Autoriteti Kontraktues nuk e ka shkelur Nenin 59 i LPP-se pika 2.3 dhe 4 - Ekzaminimi, Vlerësimi Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit për arsye se AK ka

vlerësuar konform nenit 59 pika 2,3 dhe 4 se Ne dosjen e tenderit te specifikat teknike te pozicioni 6 është kërkuar Gjatësia (m): min 9, 150 ndërsa OE ne ofertën e dorëzuar ne ditën hapjes te specifikat teknik te ofruar OE ka ofertuar me gjatësi 13340 mm (13.34m) po ashtu edhe ne broshurën e dërguar ne ofertën e juaj ditën e hapjes është gjatësia 13340 mm. AK ka kërkuar sqarime shtese nga Operatori Ekonomik dhe ne përgjigjën e pranuar nga OE është vërejtur qe ka bere ndryshimin e dimenzionit te gjatësisë për pozicionin nr. 6 si ne vijim; po ashtu edhe te specfikacion e keni bere ndryshimin tek pika nr.6. Sipas nenit 59 pika 2 te LPP-se, Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues. Andaj oferta juaj refuzohet pasi që kemi ndryshim materiali. Ndërsa Sipas nenit 59 pika 3 te LPP-se, te ndryshim e pozicionit nuk mundesh me konsiderohet devijim plus-minus 2% ky është ndryshim jo devijim. Ne dosjen e tenderit dhe njoftim për kontrate është kërkuar Katalog nga prodhuesi me përshkrim të detajuar te karakteristikave teknike , me të cilën është e mundur vlerësimi i specifikacioneve teknike te ofruara. ndërsa OE ka ofruar broshurë dhe jo katalog siç është kërkuar ne njoftim për kontrate dhe DT. AK ka kërkuar sqarim shtese rreth katalogut te prodhuesit me datën 03.11.2023 Andaj bazuar në nenin 72 të LPP dhe nenin 39.8 të RRUOPP kërkoj nga ana juaj që të na dorëzoni katalog te prodhuesit sipas kërkesës se AK te kërkuar ne dosjen e tenderit dhe ne njoftimin për kontratë. OE pas sqarimeve prape ka sjell broshurë dhe jo katalog siç është kërkuar ne DT. Ne broshurën e dorëzuar se bashku me oferte ka ofruar me dimensione te cilat mund te i gjeni te bashkangjitura në përgjigjen e kërkesës për rishqyrtim. Ndërsa ne kërkesën për sqarime ka ofruar broshurën me dimensione të bashkangjitur në përgjigjen e kërkesës për rishqyrtim. Sipas nenit 59 pika 2 te LPP-se, Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues. Andaj oferta juaj refuzohet pasi që kemi ka ndryshim materiali i ofertës. Ndërsa ju se OE keni shkelur një deklarate për specifika teknike qe ju keni dhënë për Aneksin I te dosjes se tenderit ndërsa pas sqarimit keni bere ndryshim te specifikave teknike qe janë ndryshim material i ofertës. Ndërsa sa përket OE te rekomanduar i cili pretendon se nuk plotëson te gjitha specifikat teknike AK sqaron se nuk qëndron kjo pasi qe OE i rekomanduar ka dorëzuar katalog te prodhuesit dhe jo broshurë sepse katalogu nuk mund te modifikohet ose te plotësohet pikat te cilat nuk kane qene ne katalog janë mbuluar me deklarate te prodhuesit te nënshkruar dhe vulosur. Ndërsa sa përket Autorizimit pas shitjes kriteri ne dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontrate ka qene c)Autorizimi nga prodhuesi ose Distributori i autorizuar i Prodhuesit për shitje(me titull dhe nr. Prokurimit të projektit në fjalë, në kohëzgjatje të kontratës prej 36 muaj).Autorizimi i prodhuesit lëshuar për OE te rekomanduar është plotësisht sipas kërkesës ne DT dhe Njoftim për kontrate, ne përgjigjen e kërkesës për rishqyrtim gjeni te bashkangjitur " Letter of Authorization". Pretendimet e juaj qe OE e rekomanduar nuk ka ofruar nga prodhuesi shërbime pas shitjes nuk qëndron pasi qe këto shërbim janë kërkuar nga OE dhe jo nga prodhuesi ku kemi dëshmi deklaratë nga OE i rekomanduar për se cilin kushte te kërkuar ne aneksin I Shih kërkesat ne aneksi te DT. 1. Garancioni i autobusave duhet të jetë i plotë, ku përfshihen edhe servisimet e rregullta minimum deri ne 200 000 km (vaji, filterat, set llamella, si dhe frenat), ose 3 vite cila mbërrin e para. 2.Kompania fituese është e obliguar që në momentin e nënshkrimit të kontratës te na furnizon me : "Aparaturë për diagnostikim kompjuterik dhe CD (katalogun /programin) pjesë rezeve" për modelin e autobusëve ne fjalë. Pajisja e kërkuar mund të jetë edhe një Llaptop është i instaluar programi aktual , nuk kemi kërkuar përditësim te

mëvonshëm te programit (kjo mund te behet ne baza vullnetare). 3.Kompania fituese është e obliguar që të bëjë trajnimi e së paku dy të autoritetit kontraktues. Obligative Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik: Neni 47.22. Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik është shfuqizuar ndërsa te rregullorja me te cilin është publikuar ky aktivitet neni 47 ka te beje me Procedura e kufizuar."

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 26.12.2023ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 994/23, ndërsa me datë 09.01.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2023/994 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk Pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertin shqyrtuese, ndërsa OE është Pajtuar pjesërisht me mendimin e ekspertit .

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE "Prishtina Auto" L.L.C- *eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/994 ka vlerësuar si në vijim:*

Sqarim hyrës : "lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me autobusa për Policinë e Kosovës -Ritender 1", me numër të prokurimit: 214-23-10050-1-1-1, të iniciuar nga AK – Policia e Kosovës.."

*Konstatimi i parë (I): "*Grupi i OE ankues "Prishtina Auto" L.L.LC. dhe "D&T Gropu" sh.p.k, si pretendim kryesor ankimor, sipas ankesës kane arsyetimin e eliminimit te përshkruar ne letër standarde te datës 22.11.2023, ku AK- Policia e Kosovës ka përcaktuar ne dosje te tenderit Specifikat Teknike ne pozicionin 6, është kërkuar gjatësia min. 9,150m, OE ne oferte ka dorëzuar ne ditën e hapjes për te njëjtin pozicion me gjatësi prej 13340mm (13,34 m), po ashtu edhe ne broshurën e dërguar ne ofertën e juaj ne ditën e hapjes është gjatësia 13340mm. AK ka kërkuar sqarim shtese nga OE dhe ne përgjigjen e pranuar nga OE është vërejtur qe ka bere ndryshimin e dimensionit te gjatësisë për pozicionin 6 nga 9.950 ne 12340mm, rrjedhimisht ndryshimi i dhënë nga AK është konsideruar si ndryshim material. Sipas letrës standarde AK si arsyetim te eliminimit ka potencuar se përgjatë vlerësimit te ofertave nga Grupi i OE-ve ka kërkuar sqarime lidhur me katalogët për deri sa OE ankues përmes sqarimit ka dorëzuar broshura dhe jo katalogje siç është kërkuar. Eksperti shqyrtues lidhur me këtë pretendim ankimor sqaron se AK përgjatë vlerësimit te ofertave ka kërkuar sqarim shtese nga grupi i OE-ve ankues lidhur me dimensionet e përcaktuara dhe te kërkuara ne piken 6 te specifikacionit teknik te detyrueshëm, OE ankues si përgjigjeje ndaj kërkesës ka prezantuar katalogët – broshurat për pajisjet – autobusët përkatësisht ka dorëzuar edhe deklaratën e prodhuesit e cila përmban datën 07.11.2023, ku ne te njëjtën deklarate potencohet se për këtë procedure te prokurimit do te ofrojmë: 1.Autobusët tanë do te prodhohen dhe dorëzohen ne përputhje me specfikacionet teknike te përshkruara ne Aneksin 1. 2.Autobusët tanë do te prodhohen sipas standardeve evropiane, ju lutem bashkangjitur gjeni letrën sqaruese te dosjes. 3. Ju lutemi vini e re: ne dokumentin e fundit te Aneksit 1, rreshti 6 kishte një gabim duke shkruar 13340 ne vende te kësaj duhet te jete 12340 – bashkangjitur gjeni versionin e korrigjuara. Eksperti shqyrtues bazuar ne dispozitat e nenit 59 dhe 72 te LPP-se, vlerëson se katalogu i prodhuesit është dokument i cili vërtetohet se i njëjti ka ekzistuar edhe para hapjes se ofertave, prandaj vlerësimi ynë është se sqarimet e ofruara nga OE ankues përkatësisht deklarata e datës 07.11.2023, e prodhuesit ka qene dashur te merret parasysh nga AK, marre parasysh edhe kriteret e përcaktuara ne dosjen e tenderit dhe te njoftimit për kontrate. Po ashtu neni 10 i Udhëzuesit Nr.001/2023, për Prokurim Publik, përcakton qe ne rast se është dorëzuar specifikacioni teknik për mallrat e ofruara por mungon katalogu – mund te kërkohet sqarim shtese, prandaj eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor është i bazuar. *"*

*Konstatimi i dytë (II) : "*OE ankues sipas ankesës pretendon se AK ka shkelur nenin 108/A te LPP-se, përkatësisht nuk ka nxjerre vendim bazuar ne afatin ligjor, eksperti shqyrtues këtë pretendim ankimor e vlerëson si te pa bazuar, pasi qe sipas platformës se E-prokurimit rezulton qe kërkesa për rishqyrtim është ngarkuar me datën 27.11.2023 (e hënë), ndërsa AK vendimin e ka nxjerre me datën 01.12.2023 (e premte). Me datën 28.11.2023, me Republikën e Kosovës nuk është punuar nga Administrata Publike me qe ka qene feste zyrtare. Neni 108/A paragrafi 6 i LPP-se përcakton: AK do ta shqyrtoj kërkesën brenda 3 dite pune nga data e dorëzimit te aplikimit te kërkesës për rishqyrtim, pra AK vendimin ndaj kërkesës për rishqyrtim e ka nxjerre brenda 3 ditëve te punës."

*Konstatimi i tretë (III) : "*Grupi i OE-ve ankues sipas ankesës ka ngritur pretendime ankimore edhe kundër ofertës se OE te rekomanduar për dhënie te kontratës, konkretisht kontestohet autorizimi i dhënë nga prodhuesi i produktit – autobusit si dhe garancinë për servisimet e rregullta, ashtu siç është kërkuar ne dosje te tenderit. Eksperti shqyrtues sqaron se ne letër Autorizimin e prodhuesit "ISUZU" përmes te cilit ka ofertuar OE i rekomanduar për dhënie te kontratës potencohet se prodhuesi hedhe poshtë te gjitha përgjegjësit qe mund t'i drejtohen AK ose nga OE , duke përfshirë shërbimet pas shitjes, dhe furnizimi me pjese këmbimit, AK përgjatë vlerësimet te ofertave ka kërkuar sqarime shtese nga OE i rekomanduar për dhënie te kontratës, me gjithë atë sipas sqarimeve nuk është ofruar ndonjë konfirmim lidhur me garancionin me gjithë atë ne pozicionin 2 te pikës 9.1 dhe 9.2 te FDT-se është kërkuar garancion nga OE dhe jo nga prodhuesi, përkatësisht është kërkuar servisim i rregullt min. deri ne 200.000 km ose 3 vite."

Konstatimi i katërt (IV) : "OE ankues pretendon edhe për konflikt te interesit përkatësisht për mos trajtim te pretendimeve ankimore dhe favorizim. Eksperti shqyrtues sqaron se lidhur me konfliktin e interesit nuk mund te jap ndonjë sqarim apo konstatim konkret për qeshjen e konfliktit te interesit ekzistojnë institucione përkatëse siç është AKK, përderisa për qeshje te shkeljeve te parimeve, vlerësimi ynë është se përgjatë vlerësimit te ofertave nuk janë trajtuar ofertat bazuat ne parimet kryesore meqë për shkresa te njëjta siç janë katalogët broshurat, Autoriteti kontraktues ka gjykuar ndryshe ndaj OE-ve pjesëmarrës. Prandaj, eksperti shqyrtues këto pretendime ankimore i trajton si te bazuara dhe propozon qe lënda te kthehet ne rivlerësim."

Gjetjet e Panelit Shqyrtues

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Ankuesi (me shënime si më sipër) ka pohuar shkurtimisht se ishte eliminuar pa të drejtë nga ky aktivitet i prokurimit, duke kontestuar vendimin e AK si i marr në kundërshtim me dispozitat e nenit 1,6,7,28 të LPP-së, ankuesi me tej ka sqaruar se arsyeja e eliminimit të tij në këtë aktivitet sipas letrës standarde nga AK, si kërkesë ishte e vendosur në dosje te tenderit tek specifikat teknike në pozicionin 6, sipas së cilit ishte kërkuar gjatësia "autobusin kontestues" të jetë në min. 9,150m. Lidhur me këtë ankuesi sqaron se sipas tij/saj prodhuesi i tij kishte bërë një gabim teknik shkrimor lidhur me gjatësinë e ofruar të këtij autobusi në fazën e ofertimit, i cili pastaj pas sqarimeve të kërkuara nga AK për katalog, si i tillë ishte rregulluar nga vet prodhuesi i autobusit, me deklaratë i cili sqaron për gabimin e lëshuar, e të cilat janë prezantuar si dëshmi në sistemin elektronik të e-prokurimit, dhe në asnjë rrethanë nuk ka të bëjë me ndryshim material të ofertës

siç pretendon ankuesi.

Policia e Kosovës nga cilësia e saj si AK, sqaron po ashtu se në pozicionin 6, sipas së cilit ishte kërkuar gjatësia autobusin se duhet të jetë në min. 9,150m. Kurse ankuesi për të përmbushur këtë kërkesë ne ofertën e tij/saj kishte dorëzuar "autobusin kontestues" sipas pozicion 6 me gjatësi 13340mm (13,34 m) në Ankes 1, po ashtu i njëjti edhe në broshurën e tij/saj të bashkangjitur ne ofertë për "autobusin kontestues" figuron po e njëjta gjatësi 13340mm, që rrjedhimisht përputhen ndërmjet veti. Meqenëse sipas AK ishte kontestues broshura/katalogu e njëjta kishte kërkuar sqarim shtese nga OE Ankues me datën 03.11.2023, kurse ne përgjigjen për sqarime të pranuar nga vet Ankuesi, sipas AK është vërejtur se i njëjti ka bërë ndryshimin e dimensionit të gjatësisë për pozicionin 6 në 12340mm, rrjedhimisht ndryshimi i dhënë nga OE ankues, është konsideruar nga AK, si ndryshim material për faktin se të dhënat e dorëzuara në ofertën e tij/saj në kohën e ofertimit [nënkupto Ankesin 1 për sepcifikacion teknik dhe broshurën/katalogun e prodhuesit] nuk përputhet tani me të dhënat e ofruara sipas sqarimit[nënkupto katalogun dhe deklaratën e prodhesit], i cili ndryshim sipas AK është sanksionuar me LPP dhe me nenet 38 dhe 40 të Rregullores për prokurim publik 001/2022.

Eksperti shqyrtues lidhur me këtë pretendim, në raportin e tij sqaron se OE ankues si përgjigjeje ndaj kërkesës për sqarim, kishte prezantuar "katalogun për autobusë" përkatësisht ankuesi kishte dorëzuar se bashku me të edhe "deklaratën e prodhuesit" të datës 07.11.2023, me përmbajtjen si në vijim cituar: Autobusët tanë do te prodhohen dhe dorëzohen ne përputhje me specifikacionet teknike te përshkruara ne Aneksin 1. dhe se Autobusët tanë do te prodhohen sipas standardeve evropiane, ju lutem bashkangjitur gjeni letrën sqaruese te dosjes. tutje "Ju lutem vini e re po ashtu se në dokumentin e fundit te Aneksit 1, rreshti 6 kishte një gabim duke shkruar 13340mm ne vende te kësaj duhet te jete 12340mm– bashkangjitur gjeni versionin e korrigjuar. Bazuar në këto sqarime dhe ne dispozitat e nenit 59 dhe 72 te LPP-se, Eksperti shqyrtues ka vlerësuar, se katalogu i prodhuesit është dokument i cili vërtetohet se i njëjti ka ekzistuar edhe para hapjes se ofertave, sipas neni 10 i Udhëzuesit Nr.001/2023, për Prokurim Publik.

Paneli shqyrtues pasi administroj të gjitha provat konkrete përfshirë pohimet ankimore, deklarimet e AK dhe raportin e ekspertit shqyrtues, sqaron se ankuesi ishte eliminuar nga AK, bazuar në kërkesën e dosje te tenderit tek specifikat teknike në pozicionin 6, sipas së cilit ishte kërkuar gjatësia "autobusin kontestues" të jetë në min. 9,150m, ankuesi lidhur me këtë pozicion ne ofertën e tij/saj kishte dorëzuar Ankes 1 për sepcifikacione teknike, i cili ishte nënshkruar dhe vulosur sipas së cilit "autobusin kontestues" pozicion 6, kishte gjatësi 13340mm (13,34 m), po ashtu ankuesi ne ofertën e tij/saj kishte dorëzuar edhe broshurën nga prodhuesi, sipas së cilës për "autobusin kontestues" figuron po e njëjta gjatësi e përshkruar 13340mm, që rrjedhimisht që të dyja përputhen ndërmjet veti.

Autoriteti Kontraktues për të verifikuar katalogun në fjalë kishte kërkuar sqarime shtesë nga OE ankues me dt. 03,11,2023. Ankuesi me 08.11.2024 Kishte prezantuar sqarimet e tij/saj kishte prezantuar "katalogun për autobusë" sipas së cilit "autobusi kontestues" tani figuron me gjatës 12340mm (12,34mm), përkatësisht ankuesi kishte dorëzuar se bashku me të edhe "deklaratën e

prodhuesit" të datës 07.11.2023, me përmbajtjen si në vijim cituar: Autobusët tanë do te prodhohen dhe dorëzohen ne përputhje me specifikacionet teknike te përshkruara ne Aneksin 1. dhe se sipas prodhuesit në dokumentin e fundit te Aneksit 1, rreshti 6 kishin bërë një gabim duke shkruar 13340mm ne vende te kësaj duhet te jete 12340mm.

Paneli shqyrtues, pas administrimit të të gjitha provave dhe fakteve në këtë procedurë të prokurimi, sqaron se e mbështet konstatim e eksperti shqyrtues i cili gjatë shqyrtimit të kësaj çështje i është referuar drejtë dispozitave ligjore, për faktin parimor se në cilin do format kërkesa e Dosjes së Tenderit dhe Njoftimit për Kontratë lidhur me gjatësinë është e përmbushur dhe deklarata e prodhuesit e mbulon ankuesin duke i vërtetuar deklarimet e tij se ka ndodhur një gabim teknik dhe me të drejtë eksperti shqyrtues ka konstatuar se katalogu i prodhuesit është dokument i cili vërtetohet se i njëjti ka ekzistuar edhe para hapjes se ofertave, sipas neni 10 i Udhëzuesit Nr.001/2023, për Prokurim Publik dhe me dispozitat e nenit 59 dhe 72 te LPP. Rrjedhimisht, Paneli Shqyrtues në kuptim të nenit 1, 6 dhe 7 të LPP, pretendimin ankimor e kualifikon si të bazuar dhe AK në fazën e ri-vlerësimit, në rast të dyshimit të deklarimeve dhe katalogjeve mund të fut në përdorim nenin 52.7 të LPP.

Ankuesi sipas ankesës pretendon se AK ka shkelur nenin 108/A te LPP-se, përkatësisht nuk ka nxjerre vendim bazuar ne afatin ligjor, eksperti shqyrtues këtë pretendim ankimor e vlerëson si te pa bazuar, pasi qe sipas platformës se E-prokurimit rezulton qe kërkesa për rishqyrtim është ngarkuar me datën 27.11.2023 (e hënë), ndërsa AK vendimin e ka nxjerre me datën 01.12.2023 (e premte). Me datën 28.11.2023, me Republikën e Kosovës nuk është punuar nga Administrata Publike me qe ka qene feste zyrtare. Neni 108/A paragrafi 6 i LPP-se përcakton: AK do ta shqyrtoj kërkesën brenda 3 dite pune nga data e dorëzimit te aplikimit te kërkesës për rishqyrtim, pra AK vendimin ndaj kërkesës për rishqyrtim e ka nxjerre brenda 3 ditëve te punës. Paneli shqyrtues e mbështet këtë arsyetim të ekspertit shqyrtues për shkak se është i bazuar në dokumente relevante dhe të njëjtat mund të gjenden në platformën e sistemit të e-prokurimit.

Ankues sipas ankesës ka ngritur pretendime ankimore edhe kundër ofertës se OE te rekomanduar për dhënie te kontratës, konkretisht kontestohet autorizimi i dhënë nga prodhuesi i produktit – autobusit si dhe garancinë për servisimet e rregullta, ashtu siç është kërkuar ne dosje te tenderit. Eksperti shqyrtues sqaron se ne letër Autorizimin e prodhuesit "ISUZU" përmes te cilit ka ofertuar OE i rekomanduar për dhënie te kontratës potencohet se prodhuesi hedhe poshtë te gjitha përgjegjësit qe mund t'i drejtohen AK ose nga OE , duke përfshirë shërbimet pas shitjes, dhe furnizimi me pjese këmbimit, AK përgjatë vlerësimet te ofertave ka kërkuar sqarime shtese nga OE i rekomanduar për dhënie te kontratës, me gjithë atë sipas sqarimeve nuk është ofruar ndonjë konfirmim lidhur me garancionin me gjithë atë ne pozicionin 2 te pikës 9.1 dhe 9.2 te FDT-se është kërkuar garancion nga OE dhe jo nga prodhuesi, përkatësisht është kërkuar servisim i rregullt min. deri ne 200.000 km ose 3 vite. Paneli shqyrtues konsideron se konform nenit 56.3 të LPP, asnjë operator ekonomik nuk mund të eliminohet për ndonjë kërkesë e cila nuk është e vendosur në Dosje të Tenderit dhe Njoftimit për Kontratë, por duke u bazuar ne dokumentet te cilat janë te ngarkuar edhe ne sistem te E- prokurimit, konstatohet pretendimi i Ankuesit se autorizimi përmban të meta , jo sa i përket validitetit, por sa i përket përmbajtjes

sepse përmes autorizimit, prodhuesi është distancuar nga të gjitha përgjegjësit dhe jo vetëm për shërbimet pas shitjes dhe furnizimit me pjesë, por edhe nga trajnimet, gjë që kjo bie ndesh pastaj me obligimet e OE i cili mund të jetë fitues dhe është i obliguar që kërkesat e vendosura tek specifikimi teknik tju përmbahet dhe ti realizoj me rastin e implementimit të kontratës.

Andaj, Paneli Shqyrtues konsideron se në kuptim të nenit 7, trajtimit të barabartë të palëve në këtë procedurë gjatë fazës së ri-vlerësimit të kërkohen nga AK sqarime shtesë edhe për OE të rekomanduar për kontratë se si mendon ta realizon këtë kontratë, qoftë edhe me deklaratë të prodhuesit, me qëllim që mos të vij deri tek më e keqja, siç është problemet në realizim të kontratës dhe/ose ndoshta dështimi i saj.

Ankues pretendon edhe për konflikt te interesit përkatësisht për mos trajtim te pretendimeve ankimore dhe favorizim. Eksperti shqyrtues sqaron se lidhur me konfliktin e interesit nuk mund te jap ndonjë sqarim apo konstatim konkret për qeshjen e konfliktit te interesit ekzistojnë institucione përkatëse siç është AKK. Të njëjtin mendim sa i përket konfliktit të interesit, OSHP njofton palën se nuk është në domenin dhe kompetencën e këtij institucioni trajtimi i pretendimeve për konflikt të interesit, andaj udhëzohet pala që për këtë pretendim mund t'ju drejtohet institucioneve kompetente që janë mbikëqyrëse të Ligjit Nr.06/L-011 Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik. Edhe pse pas shikimit të shkresave AK në përgjigje ndaj raportit të ekspertit shqyrtues ka njoftuar OSHP se personi në fjalë ishte tërhequr nga zhvillimi dhe vlerësimi i kësaj procedure të prokurimit.

Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në ketë rast përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse në të kundërtën do të bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Po ashtu, vlerëson se të dy OE përfshirë të rekomanduarin dhe ankuesin, kanë të meta, andaj duhet të trajtohen konform nenit 7 të LPP. Kthimi i një aktivitetit të prokurimit me bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht ne pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos po ashtu edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës bazuar edhe në neni 24 paragrafi 2 të LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në

përputhshmëri të plotë me këtë ligj”.

Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe i analizoi me kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde dhe konsideron se pohimi ankimor i OE ankues është pjesërisht i bazuar

Paneli shqyrtues në këtë vendim marrje ka pasur ne konsideratë edhe kërkesat e nenit 104, paragrafi 4 të LPP, sipas të OSHP duhet të veprojë sa më shpejtë që të jetë e mundshme, të veprojë në mënyrë proporcionale me shkeljen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **POLICIA E KOSOVËS**
- OE - **" Prishtina Auto " L.L.C.**
- Arkivës së OSHP-së: